




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-24960/20 datë:11.12.2020



Npi – 01/317 datë: 22.12.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 22.12.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -X- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
E mbajtur më: 22.12.2020, e (martë) në ora 10.⁰⁰ h. ON-LINE në sallën e vogël.

Mbledhja e Kuvendit është mbajtur ON-Line (nga distanca) për shkak të pandemisë KOVID19, Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj me nënshkrimin e sajë konfirmon se në mbledhje kanë marrë pjesë të gjithë anëtarët e Kuvendit, si vijon: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Arresha Syla, z.Milot Deliu, z.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, z.Zarife Rexhaj, z.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, z.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, z.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, z.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen e Kuvendit nga distanca. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 24.11.2020,
2. Pyetje-Pergjigje,
3. Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2021,
4. Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes,
5. Draft-Plani Lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes,
6. Propozim-Ndryshimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Npi-01/114 dt.26.04.2019,
7. Draft-Plani i Punës së Kuvendit për Vitin 2021,
8. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2021,
9. Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim,
10. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike,
11. Informatë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj;Hapidiskutimin për rendin e ditës.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje për të gjithë, unë nuk kam ndonjë vërejtje për rendin e ditës, por po e ngris një çështje që ka të bëj me mbajtjen e mbledhejes së Kuvendit nga distanca, sepse vetëm Komuna e jonë po i mban mbledhjet nga distanca (On-line), dhe pyetja është pse mos të mbahet mbledhja në sallën e Kuvendit kur dihet se ka vend të mjaftueshëm për mbajtjen e distancës, por edhe duke pas parasysh faktin se gjithkund po mbahen nëpër salla e ashtu po ndodhë edhe në Kuvendin e Kosovës. Më parë arsyetimi ka qenë se ka anëtarë të Kuvendit por edhe nga stafi i

shërbyesve civiltë që janë të infektuar me virusin Kovid19, e që tani më ka kaluar. Dhe një pyetje e kam se a ka pas kërkesa të adresuara në Kuvend apo jo, sepse nuk e kemi në këtë mbledhje Listën me kërkesa?

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Jam në dijeni për propozimin e juaj që e keni dërguar me E-mail, që mbledhja të mbahet në sallën e Kuvendit, por arsyetimi është se edhe tani e kemi të infektuar znj. Arbresha Syla me virusin Kovid19, kështu që duke mos dashur për me rrezikuar, edhe kësaj radhe kemi vendosur që mbledhjen e Kuvendit ta mbajmë On-line. Shpresoj se mbledhjen e radhës do ta mbajmë në sallën e Kuvendit. Sa i përket pytejes për listën e kërkesave, ka pas zyrtarë të infektuar të cilët është dashur të dalin në teren për të bërë raport lidhur me kërkesat e caktuara që kryesisht kanë të bëjnë me shpronësimet, e që nuk kanë mund të dalin e ta kryejnë punën e tyre, për kët arsyen edhe nuk e kemi futë si pikë të rendit të ditës.

znj. Arbresha Syla; Përshëndetje, U.A. duhet të zbatohet, ideja e mbajtjes së mbledhjeve On-line është se po përballemi me një situatë të pandemisë Kovid19. Unë e di se kjo formë e mbajtjes së mbledhjeve On-line është më e komplikuar se sa mbajtja në sallën e Kuvendit, por kur e kemi parasysh ruajtjen e shëndetit është absurde të kërkohet që mbledhja të mbahet në sallën e Kuvendit.

z. Perparim Ramusa; Përshëndetje për të gjithë, Arbreshës i uroj shërim sa më të shpejtë. Unë pajtohem me rendin e ditës.

z. Shefki Dauti; Përshëndetje, në emër të grupit parlamentar të PDK-së pajtohemi me rendin e ditës.

z. Ruzhdi Jashari; Përshëndetje për të gjithë, unë po i ngris disa çështje. E para nëse ne si Komunë jemi në zonën e gjelbërt, atëherë nuk vlejnë masat strikte që po ndërrmirren sepse nuk mund te behemi më pap se papa, siç thot fjala a popullit, kjo edhe përfaktin se po humbet kualiteti, pastaj edhe ne disa po kemi mungesë të energjisë elektrike e që po ndodhë pa fajin tonë. Kryesuesja e Kuvendit duhet me vendosë sipas kërkesës së shumicës së anëtarëve të Kuvendit, e në këtë rast shihet se shumica e kanë përkrahur propozimin e Fehmi Hysenaj, përmajtjen e mbledhjes në sallë. Prandaj po e përsëris që ne jemi fuqimisht përmajtjen e mbledhjeve të Kuvendit në Sallë. Dua që me këtë rast ti shpreh ngushllime, zyrtarit të Kuvendit Idajet Rexhepit me rastin e vdekjes së familjarit të tijë tashmë të ndjerë, Behxhet Rexhepi. Në fund kamë një propozim konkret, Propozoj që në rendin e ditës të futet si pikë shtesë "Ndihmë për personat e prekur me Kovid19".

z. Besnik Seferi; Përshëndetje, sa i përket mbajtjes së mbledhjeve On-line, unë mendoj se nuk ka kualitet, dhe meqenëse në Shtëpinë e Kulturës është mbajtur një Komedji, edhe ne si Kuvend mund ti mbajmë mbledhjet në sallën e Kuvendit. Unë propozoj që ne si Kuvend të marrim vendim përmes e nda një pjesë të mjeteve buxhetore përmes ndihmës së prekurt me Kovid19.

z. Fehmi Hysenaj; Ju kisha lutë që kërkesën time mos ta kuptioni përmirësuar përmirësuar, dhe përmirësuar kualitetet më të mirë të punës së Kuvendit. Unë plotësisht i kuqtoj respektimin e masave, dhe i pari jam që kam kërkuar mbajtjen e mbledhjeve On-line. Mirëpo ka pas E-mail që e kanë prkrahur propozimin tim përmajtjen e mbledhjeve të Kuvendit në sallë.

z. Naim Zejna; Përshëndetje, edhe unë i bashkëngjitem propozimeve që mbledhjet të mbahen në sallën e Kuvendit. E sa i përket propozimit të Besnikut, nuk është larg mbledhja e radhës, e që besoj se do ta mbajmë me prezencë fizike në sallë, dhe të përgatitemi përmes një propozim të tillë përmirësuar e një pjesë të mjeteve buxhetore përmes ndihmuar së prekurt me Kovid19.

Kryetari, z. Naim Ismajli; Përshëndetje, e mora fjalën përdyshi arsyen. E para organizimi i mbledhjes në sallë nuk do të ishte problem, por në momentin kur është thirrë mbledhja, Shtimja nuk ka qenë në zonën e gjelbërt. Unë e di që mbajtja e mbledhjes On-line mund të ketë vështërsi, por jo në masën që të humbet kualiteti. E dyta është qështja e propozimit përmes ndihmës financiare përmirësuar së prekurt me Kovid19. Ju e dini se tani jemi në fund të vitit buxhetor, nesër i mbarojmë të gjitha pagesat financiare, kështu që një vendim i tillë nuk prodhon efekte, po ashtu edhe përmirësuar vitin e ardhshëm 2021 nuk është i mirë një vendim i tillë përfaktin se ende nuk është aprovuar Buxheti i Kosovës. Nuk duhet të propozohen vendime populiste, sa përmirësuar veshin e qytetarëve, sepse pastaj mund të

del qështja gabim. Në mbledhjen e radhës do të prezantojmë një raport, ku do të shihet nëse si Komunë i kemi shpërndarë pakot për të gjithë të prekurit me Kovid19, dhe për të gjithë të sëmurit kronik, sepse nevojat e banorëve janë të ndryshme, edhe sipas shumave edhe sipas mënyrës së ndihmave që u duhen.

z.Ruzhdi Jashari; Replikë, propozimi ynë si Vetvendosje nuk është populist, sepse ka bazën ligjore, dhe mbi këtë bazë ne si Kuvend i kemi nda njëqind mijë euro për të marrë masa në mbrojtjen nga virusi Kovid19. E dyta kjo pra shkon në të mirën e qytetarëve në këtë kohë të panedmisë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje On-Line.

* **Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24.11.2020

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 24.11.2020.**

Pika 2

Pyetje-Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj; Unë e kam vetëm një pyetje, është fjala për humbjen e shumë orëve të mësimit te klasët e dhjeta në lëndën e Fizikës. Kjo nuk guxon të përsëritet, qka keni ndërrmarrë për zëvendësimin e tyre. Dhe e dyta kam një vërejtje, gjatë punimeve te Pishat te pjesa e asfalltit, kanë qenë shumë të pa kujdeshëm, këshjtu që i kanë mbushur pusetat me asfallt, Drejtoria duhet me ndërrmarrë diqka për këtë?

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, unë kam një pyetje sa i përket Urës në fshatin rashincë, ajo urë duhet të përfundohet sa më shpejt, dhe banorëve duhet që tu mundësohet një rrugë alternative.

z.Ruzhdi Jashari; Nga pyetjet e kaluara, në një pyetje nuk kam përgjigje fare, ndërsa te pyetja për DKA-në, del si përgjigje se te arsimi është qdo gjë në rregull. Ne po kërkojmë që mos të ndodhin projekte pa u bërë shpronësimi i rregullt i pronave, nga ana e ekzekutivit. Kërkesat e palëve duhet të trajtohen sepse ka kërkesa të reja, sikurse është kërkesa nga Ekrem Shabani.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sa i përket virusit Kovid19 e ke marrë përgjigjen të shkruar edhe ti edhe gjithë të tjerët.

Pika 3

Draft-Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe në vazhdim fjalën ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, Zyrتare Kryesore Financiare; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, kemi përgatitur këtë propozim Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2021. Ndryshimet e propozuara kanë ardhur nga organizatat buxhetore si vijon, në vazhdim lexoi të gjitha propozimet e bëra nga organizatat buxhetore për ndryshimin e kësaj rregullore. Materialin për këtë rregullore e keni pas, unë nuk kam më tepër të shtoj por nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem. Ju ftoj që këtë rregullore ta aprovon.

z.Fehmi Hysenaj; Materialin e kemi marrë me kohë. Unë kam edhe disa propozime konkrete por meqenëse do të dalë në diskutim publik, propozimet do ti bëj me shkrim. Një gjë që na bjen në sy te

kjo rregullore është se mungon elementi i gjobave, ku unë mendoj se duhet të inkorpoprohet në këtë rregullore.

z.Naim Zejna; E përkrahim propozimin për me dalë në debat publik, por është dashur të vijnë në formën e plotë. Unë kam thënë që çdo rregullore që ka implikime buxhetore duhet të vijë në Kuvend për aprovim para buxhetit.

z.Shefki Dauti; Pasi që ka me kaluar nëpër diskutim publik unë mendoj se nuk ka nevojë që të debatojmë tanë por që menjëherë të votojmë.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, meqenëse del në debat publik, aty ne mund ta japim kontributin.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-Line.

* **Kuvendi Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Propozim-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2021, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 4

Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Besnik Shala.

z.Besnik Shala, zyrtar i personelit; Përshëndetje, sipas kërkesës së Kuvendit ne kemi hartuar Draft-Kodi Etik i Komunës së Shtimes. Fillimi është formuar komisioni në përbërjen e të cilit nga Kuvendi janë, Naim Zejna dhe Fatmire Ferati. Komisioni ka mbajtur gjithësejt tri mbledhje. Ky Kod Etik ka për qëllim që të rregulloj avansoj dhe promovoj sjelljen etike të gjithë anëtarëve të Komunës së Shtimes. Unë ju ftoj që ta aproponi, por nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu që të përgjigjem.

z.Naim Zejna; Unë kam qenë pjesë e Komisionit. Është punuar një draft i mirë, kështu që unë propozoj që ta dërgojmë për dikutim publik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-Line.

* **Kuvendi Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Kodin Etik të Komunës së Shtimes, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 5

Draft-Plani Lokal i Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi rekomandimin e KPF-së, dhe në vazhdim fjalën ja dha Hamëz Tërshani.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Përshëndetje, ky është një dokument strategjik që ka për qëllim adresimin e problemeve në mjedis. Bazën Ligjore e ka dhe është e shkruar në dokument. Në bashkpunim me organizatën SNP-ë komisioni ka mbajtur dy mbledhje, ku edhe është hartuar draft-dokumenti të cilin tanë ju e keni përparrë, të cilin unë ju ftoj që ta aproponi, meqenëse ky Plan është shumë i rëndësishëm edhe për performancën e Komunës.

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, ky pra është një Draft-Plan shumë i rëndësishëm për komunën tonë, në të cilin janë përfshirë të gjitha nevojat. Ne e kemi këtë draft në E-mail, dhe po besoj se dp të shkojë në diskutim publik, ku edhe mund të japim kontributin tonë në përmirësimin e tijë.

z.Naim Zejna; Pajtohem që të shkojë në diskutim publik, por meqenëse është dokument strategjik, unë po kërkoh që në debat të përfshihen edhe anëtarët e Kuvendit, sepse ka profesionist të kësaj fushe.

z.Fehmi Hysenaj; E falënderoj drejtorin për prezantimin, ky dokument ka brum të mjaftueshëm që të shkoj në diskutim publik. Do ti bënte nderë Kuvendit që në dokumentet e tillë strategjike të marrin

pjesë edhe opozita. Në dokumewnt ka disa gabime të vogla të cilat unë do ti dërgoj me shkrim. Unë mendoj se secili aktivitet i paraparë me dokument duhet të ketë edhe një kosto buxhetore.

z.Ruzhdi Jashari; Flm. Për fjalën, sa i përket këtijë Plani i cili ka një afat kohor mjaft të gjatë, ne si Vetvendosje kemi propozime konkrete. E para në këtë dokument strategjik, çështja e Gurëthyesve nuk është trajtuar sa duhet, kur dihet se në komunën tonë kemi një numër mjaft të madh të operatorëve që merren me këtë veprimtari. E dyta nuk është marrë parasysh edhe çështja e trashëgimis natyrore ku ne mendojmë se duhet të ketë hapsirë më shumë në këtë dokument strategjik. Dhe e treta çështja e trashëgimis kulturore e historike, siq është psh. "Masakra e Reçakut" pastaj "Ahmet Shtimja" etj. të cilat po ashtu duhet të kanë vend meritor dhe të inkorporohen në dokument.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Këto propozime i ka marrë të gjitha drejtori dhe do ti ketë parasysh në procesin e diskutimit publik.

znj.Zarife Rexhaj; Përshëndetje, unë propozoj që stacioni i policisë në Shtime, të jetë pjesë e trashëgimisë kulturore, si muze historik, për shkak të malltretimeve që u janë bërë shqiptarëve në këtë stacion policor, nga rexhimi i atëhershëm jugosllav.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, edhe unë jam që ky Plan të del në diskutim publik. Kemi shumë degradime të lumejve që nuk janë përfshirë në dokument, pastaj asfalltimi i rrugës deri te shpella e Pjetërs hicës nuk është bërë përkundër premtimeve, dhe ndarjes buxhetore. E përkrahu propozimin e Zarife Rexhaj, që stacioni policor të mbetet muze, për vuajtjet që u janë shkaktuar shqiptarëve aty.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent On-Line.

* **Kuvendi Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Planin Lokal të Veprimit për Mjedis 2021-2025 për komunën e Shtimes, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 6

Propozim-Ndryshimet në Rregulloren e Punës së Kuvendit, Npi-01/114 dt.26.04.2019

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi rekomandimet e Komisionit, për ndryshimin e rregullores të punës së Kuvendit të Komunës, duke lexuar të gjitha rekomandimet.

z.Fehmi Hysenaj; E falënderojmë Komisionin që ka punuar në këtë dokument. Dy gjëra këtu janë të pakuptimta, te neni 6.2, ku pajtohem me atë që e thot Ligji, por nuk ka kuptim që anëtarë i Kuvendit njëher të votojë "Kundër" e pastaj të votojë "Për" për propozimin që e ka bërë vetë. Unë kam propozuar që fillimisht të votohet për propozimin e bërë nga anëtarë i Kuvendit, e pastaj të votohet propozimi që ka ardhur nga Kryesuesi. Këtu pra kemi një konfuzion, që unë kam këruar të eliminohet.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ju e keni mundësinë që përmes E-mailit të bëni propozimet e juaja për rendin e ditës, gjatë gjithë kohës brenda muajit. E që këtë e ka shfrytëzuar disa herë Fehmi Hysenaj.

z.Naim Zejna; Flm. Për fjalën, te neni 3.6 sa i përket krijimit të kushteve, mund të them se kemi kushte, por ndoshta do të ishte mirë me pas një monitor më të madh. Kryesuesja nuk i lexoi propozimet që nuk kanë kaluar në KPF-ë ku unë kam propozuar që 1/3 e anëtarëve kanë të drejtë me thirrë mbledhje, meqenëse mbledhjet e jashtëzakonshme duhet të jenë me një pikë të rendit të ditës. Unë po propozoj që kjo dmth. 1/3 e anëtarëve të ketë mundësinë që të propozoj një pikë shtesë të rendit të ditës e cila duhet pastaj të futet automatikisht në rendin e ditës. Tjetër, pikat që kanë një volum më të madh siç është Buxheti i Komunës, propozoj që të rritet minutazha për përfaqësuesit e subjektit në 10 minuta ndërsa për anëtarët tjerë në 5 minuta. Dhe e fundit sa i përket mirësjelljes duhet të harmonizohet me Kodin Etikës, nuk e di a është lexuar nga Kryesuesja, mirëpo unë propozoj që edhe në Kuvend të qitet në votim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Këto ndryshime të propozuara për rregulloren e punës së Kuvendit nuk ka nevojë që të shkojnë në diskutim publik, sepse edhe nuk ka pas ndonjë propozim për diskutim publik.

z.Besnik Seferi; Unë kam qenë pjesë e Komisionit, unë nuk pajtohem me propozimin te nenii 6.2 që ka të bëj me renditjen e hedhjes në votim të propozimeve ku thuhet se propozimi i Kryesuesit, hedhet i pari në votim, unë nuk pajtohem me këtë propozim, sepse unë kam propozuar në Komision që së pari në votim të qiten propozimet që jasin anëtarët e Kuvendit e pastaj të votohet për propozimet e Kryesuesit, ky propozim pra është i evidentuar edhe në procesverbal të Komisionit si propozim që e kam dhënë unë, për këtë arsy që nuk mendoj që të shkojë kështu si është.

z.Fehmi Hysenaj; Për hirë të efikasitetit unë e përkrahu propozimin e Besnikut, me kusht që propozimi të jetë një çështje urgjente, dhe propozimet t'i bashëngjiten propozimeve të Kryesuesit dhe kështu komplet në paketë të qitet në votim.

z.Shefki Dauti; Nuk ka dilemë se të gjithë kanë të drejtë në propozime, çështja është se cili propozim del i pari në votim. Mund të propozohen 5 pika, por mund të shkojë e të shtohet si pikë shtesë vetëm një pikë. Në rregullore është shumë e çartë se kur kalon një propozim nuk ka nevojë për votim tjetër.

z.Ruzhdi Jashari; Nuk ka logjikë të shkojë në diskutim publik. Te nenii 6.2 na prishë punë dhe është fatale për demokracinë, sepse po del në shesh përparsia e Kryesueses, ndërsa që ajo është e barabart me neve. Propozimi konkret është që pika 2 e nenit 6 të fshihet dhe të shkruhet nenii 47pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale. Kjo ngulfatje nuk duhet me vazhduar më tutje kështu. Ne do ta qojmë në zyrën ligjore të ministrisë dhe te avokati i popullit. Pse mos e bërë kështu si po e propozojmë ne. Te konflikti i interesit, e kemi ligjin për konfliktin e interesit, kështu që nuk ka nevojë me e futë në rregullore, sikurse edhe çështjet e Kodit Etik.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ne e kemi përmendur një herë nenin 47.2 të LVL-së në rregullore, si dhe ka kaluar nëpër filtrat e komisionit dhe KPF-së. Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje On-Line. Dhe në vazhdim lexi propozimet që do të hedhen në votim, si dhe rekomandimet e KPF-së.

* **Kuvendi i Komunës, me 15 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” aprovoi, ndryshimet e Rregullores së punës së Kuvendit dhe Komiteteve me numër: Npi-01/114 dt.26.04.2019, si vijon:**

1. Te neni 3 shtohet neni i ri 3.5 “Kuvendi, Komitetet dhe Trupat tjera të Kuvendit mund të organizojnë mbledhje nga distanca (on-line) në kushte të veçanta”.
2. Te neni 3 shtohet neni i ri 3.6 “Një ose më shumë anëtarë të Kuvendit për shkaqe të arsyeshme personale mund të kërkojnë që të marrin pjesë në mbledhje të Kuvendit dhe trupave të tij nga distanca (on-line) dhe kjo duhet t'u mundësohet nga Kryesuesi-ja dhe Sekretaria e Kuvendit”.
3. Te neni 4 shtohet neni i ri 4.2 “ Pjesëtarëve të publikut që marrin pjesë në mbledhje duhet t'u kërkohet paraqitja e rastit-rasteve të konfliktit të interesit dhe nëse ka, nuk duhet lejuar të marrin pjesë në mbledhje kur shqyrtohet rasti i tyre”.
4. Neni 6.2 i rregullores mbetet i njëjtë.
5. Te neni 6 shtohet neni i ri 6.3 që ka të bëj me nenin 47.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon 6.3 “Anëtarë i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të kuvendit të komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike ”.
6. Pjesa që ka të bëjë me mirësjelljen e anëtarëve të kuvendit dhe trupave punuese të tij duhet të harmonizohet me Kodin Etik Komunal.

Pika 7
Draft-Plani i Punës së Kuvendit për Vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi Draft-Planin e Punës së Kuvendit për Vitin 202, në pikat kryesore, si dhe propozimet që kanë dalë nga z.Jashari e të cilat janë inkorporuar në draft-planin e punës së Kuvendit. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Propozimet e KPF-së është dashur të hedhen në votim. Unë po kërkoj që të evidentohet në procesverbal se janë anashkaluar propozimet që i kam dhënë në KPF-ë. Te plani i punës Masakra e Reçakut duhet me u përfshi patjetër. Pastaj e kemi muajin dhjetor i cili është faktikisht muaj elektoral.

z.Fehmi Hysenaj; Mënyra se si shkoi pika 6 paraprake është krejtësisht gabim, asnjë propozim nuk shkoi. Për sa i përket planit të punës, ne duhet ta kemi një plan dhe unë jam që të kalojë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-Line.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2021.**

Pika 8
Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit për vitin 2021
Draft-Plani i Punës së Kuvendit për Vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Prezantoi këtë pikë dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj; Orari është mirë, por vetëm po kërkoj që në muajin dhjetor mbledhja të mbahet ditën e martë më 22.12.2021.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent On-Line.

* **Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, orarin për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës së Shtimes për vitin 2021.**

Pika 9
Formimi i tri Komisioneve Vlerësuese për Dhënen e Pronës Komunale në Shfrytëzim

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për këtë pikë do të na i paraqet rexhia propozimet që i ka dhënë ekzekutivi. Pas pak në monitor u shfaqen tri propozimet nga ekzekutivi për formimin e tri komisioneve Vlerësuese për dhënen e Pronës Komunale në Shfrytëzim. Tani na mbetet neve si Kuvend që ti japid propozimet tona, në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Shekji Dauti; Në emër të subjektit të PDK-së unë propozoj që për Zonën Kadastrale-Davidovc, Herolind Selmani, për Zonën Kadastrale-Dugë Arbresha Syla, dhe për Zonën Kadastrale-Shtime, Përparim Ramusa.

znj.Zarife Rexhaj; Unë propozoj, për Zonën Kadastrale-Davidovc, Skender Hyseni, për Zonën Kadastrale-Dugë, Valentina Halili-Ferati, dhe për Zonën Kadastrale-Shtime, Naim Zejna.

z.Fehmi Hysenaj; Subjekti politik LDK-ja po shihet që po tregon një shpirt-ngushtësi që e ka, sepse të gjithë anëtarët i propozoj nga subjekti i vetë i LDK-së. Unë nuk do të propozoj, por vetem desha ta theksojë se LDK-ë nuk e ka mirë.

z.Ruzhdi Jashari; Së pari kjo çështje fare nuk është në përputhje me ligjin, sepse nuk janë përfilluar procedurat, mungon Lista e pronave për shpronësim, nuk ka asnjëloj Planifikimi. Në vendimet e mëparshme që i ka kthyer MPL-ja në rishqyrtim, vetëm emrat janë shlyer, sepse edhe emrat e atyre që kanë bërë kërkesa ishin shkruar në vendime. Tani nuk ka mbetur edhe shumë, edhe radhën e kemi ne dhe këto do ti rregullojmë pas zgjedhjeve. Pra që nga fillimi është në kundërshtim me rregulloren e MPL-së për zbatimin e procedurave që ka të bëj me dhënen e pronës komunale në shfrytëzim. Në kundërshtim është edhe procedura këtu në Kuvend ku po shihet se LDK-ja është bërë pateric, e

pushtetit dhe epen 3 propozime në emër të opozitës, dhe të tre emrat propozohen nga partia e vetë LDK-ë. Ne nuk do të jemi pjesë e kësaj vendimarrje të paligjshme.

z.Skender Hyseni; Përshëndetje, unë nuk do ta pranoj propozimin për Komision, por do të propozoj Fehmi Hysenaj, nga NISMA, në vendin tim.

z.Besnik Seferi; Kryesuesja na tha se formimi i komisioneve është në përputhje me ligjin, ju lutem na thoni me cilin Ligj dhe në bazë të cilit nen.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Ne mundemi me ua dërguar materialin dhe i shihni.

z.Rexhep Gashi; E kemi pas një komision që ka punuar edhe më parë dhe nuk është për me u quditur me këto propozime, sepse është i formuar prej pozitë-pozitë, PDK-LDK krejt njësoj, dhe dihet që nuk ka opozitë.

z.Naim Zejna; Ne nuk e dimë se a i pranoni anëtarët tonë të LDK-së, por e ruajmë të drejtën që ti propozojmë anëtarët tanë. Mirëpo siq po e shihni ne jemi gjentëllmen dhe e propozuam Fehmiun, kështu nëse janë të interesuar edhe Ruzhdiju edhe Besniku le të futen unë mund të tërhiqem.

z.Rexhep Gashi; Jemi larg, se po të ishim afér nuk kishe mujt me i thënë këto fjalë përfkime, sepse ne e dimë se sa keni kontribuar.

z.Fehmi Hysenaj; Unë e dhash një vërejtje, tani doli një propozim përmua, unë nuk i iku përgjegjësisë, dhe do ta pranoj.

znj.Zarife Rexhaj; Zotëri Gashi juve ju ka ra pesha e votës pikërisht për punën, faktikisht për mospunën e juaj, lidhur me ate që u tha se nuk ka opozitë.

z.Naim Zejna; Nuk dua ta ofendoj askend, sepse ne jemi parti serioze. Ne e dimë se ku kanë qenë, ku janë, dhe ku po shkojnë këta.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent On-line.

1. Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Vendimin për zgjedhjen e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme Komunale, në Zonën Kadastrale – Dugë, si vijon:

Arbresha SylaAnëtarë e kuvendit (Pozitë)

Valentina Halili-Ferati....Anëtarë e kuvendit (Opozitë)

Arben Lami.....Përfaqësues i ekzekutivit (DPUKGJ)

Adelina Veseli.....Përfaqësuese e ekzekutivit (DZHE)

Imer Tërshani.....Përfaqësues i Klubit të Biznesit

2. Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Vendimin për zgjedhjen e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme Komunale, në Zonën Kadastrale – Davidovc, si vijon:

Herolind Selmani..... Anëtarë i Kuvendit (Pozitë)

Fehmi Hysenaj..... Anëtarë i Kuvendit (Opozitë)

Ajshe Tërshani..... Përfaqësuese e ekzekutivit (DPUKGJ)

Bashkim Ahmeti..... Përfaqësues i ekzekutivit (DZHE)

Arben Bajrami..... Përfaqësues i Klubit të Biznesit

3. Kuvendi i Komunës, me 16 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” aprovoi Vendimin për zgjedhjen e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme Komunale, në Zonën Kadastrale – Shtime, si vijon:

Perparim Ramusa..... Anëtar i Kuvendit (Pozitë)

Naim Zejna..... Anëtar i Kuvendit (Opozitë)

Sami Jonuzi..... Përfaqësues i ekzekutivit (DPUKGJ)

Safet Brahimë..... Përfaqësues i ekzekutivit (DZHE)

Halim Baftiu..... Përfaqësues i klubit të Biznesit

Vendimet janë aprovuar duke marrë parasysh propozimet e Ekzekutivit, si dhe propozimet e aprovuara me votim, duke bërë ndryshimin te kandidati i propozuar, Skender Hyseni i cili është larguar vullnetarisht dhe është zëvendësuar me Fehmi Hysenaj.

Pika 10

Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Hamëz Tërshani.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Pasi përvendetetë të gjithë prezantoi këtë pikë duke lexuar informatën. Ai tha se informatën e keni marrë të shkruar dhe e keni lexuar prandaj unë nuk do ta zgjati shumë, jam këtu për tu përgjigjur në pyetjet e juaja eventuale, (shih dokumentin).

z.Naim Zejna; Faleminderit për informatën, sa i përket pastrimit të rrugëve nga bora qe 3 vite nuk e di fare se si është bërë. Te gjatësia e rrugëve duhet të shënohet me metra sepse gjatësia nuk është koresponduese. Tjetra si është paraparë pastrimi i rrugëve me apo pa trotuare, duhet me na e sqaruar pak. Te pastrimi i varrezave po ashtu me na sqaruar se si është menduar të bëhet, duhet me qenë pak ma preciz. Dhe çështja tjetër te pika dy e kontratës, sa i përket shirave të rrëmbyeshëm, sivjet nuk di nëse kemi pas shi të rrëmbyeshëm. Është thënë se dezinfektimi është bërë disa herë, sa herë është bërë 1, 10 sa herë.

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për informatën, unë realisht kam pritur që informata të jetë më precise, dhe të jetë me interes. Po vërehet edhe në titull se nuk është përfshirë Inspektorati me qëllim që të pasqyrohen disa punë e që besoj se kanë pas punë për shkak të pandemisë Kovid19. Nuk ka denime për mosrespektim të masave ndaj Kovid19.

z.Ruzhdi Jashari; Çështja më e rrezikshme është te rruga "Ahmet Shtimja" afër Xhamisë së madhe, që aty disa shtylla paraqesin rrezik të madh. Pastaj çështje tjetër te sheshi është edhe çështja e telave të telefonisë, është po ashtu e pa pranueshme që nuk ka një tabelë askund që tregon se ekziston një Muze në Shtime, pra mungon një shenjë e informimit. Nuk kemi asnjë raport e as në informatë nuk është përfshirë puna e Inspektoratit. Po ashtu nuk kemi asnjë informatë për sa i përket vërvimeve që kanë ndodhur në komunën e Shtimes.

z.Muhamed Ademaj; E falënderoj drejtorin për informatën. A ka drejtori për shërbime publike një plan për ti futur të gjitha amvisëritë në sistemin e pagesave për mbeturina?

z.Besnik Seferi; Unë e kam paraqitur edhe më parë si shqetësim çështjen e vendosjes së kabllove nëpër shtylla ku jan mbushur përplot, nuk e di a ka inspektorat për ti kontrolluar. Ne i shohim për çdo ditë që po ka dhe po shtohen ngarkesa me tela. Te fusha e sportit në fshatin Gjyrkovic është rrezik i madh sepse kabllat kanë ra poshtë në tokë, çka ka ndërrmarrë drejtoria për këtë? Shqetësuese është edhe gjendja e rrugës "Çamëria" ku aty është bërë deponi, edhe sa duhet pritur që aty të hiqen mbeturinat, e pastaj ne vetë banorët e Lagjës e mirëmbajmë.

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Sa i përket Kontratës për pastrimin e rrugëve nga bora edhe më herët ka qenë 3 vjeçare, e edhe kjo ashtu. Për sa i përket gjatësisë së rrugëve që janë përfshi në pastrim, mund të ketë gabime, por scili nga ju mund të vini dhe ti shihni në detaje. Mirëpo ne do të angazhohemi që ti mirëmbajmë të gjitha rrugët e komunës së Shtimes. Sa i përket Varrezave, pastrohet vetem rruga që qon deri te Varrezat e jo edhe hapsirat brenda Varrezave. Sa i përket vërvimeve ne e kemi raportin që është i detajuar. Vërejtja është me vend për Inspektoratin, por nga unë është kërkuar vetëm për shërbime publike. Për sa i përket dezinfektimit dhe deratizimit, sivjet e kemi bërë më shumë se dy herë. Është e sigurtë se rrjeti me tela është i stërvitshëm, por që është i trashëguar ashtu dhe KEDS e ka atë pavarësinë e veprimit, kështu që unë mendoj se niveli qendror duhet të bëj diçka më shumë. Telat e telefonisë e kabllovikut janë në gjendje të keqe, dhe nuk mund të themi tani se ka me u rregulluar shpejt. E siguroj z.Jasharin se kamë me marrë në shënim, për sa i përket sinjalizimit për Muzeun e Komunës së Shtimes. Kabllot që kanë ra te fusha e sportit në

Gjyrkovic i kemi pa bashkë me Inspektorët, dhe ata janë zotuar se kanë me i rregulluar këto prishje. Te rruga “Camëria” kemi bërë vizita dhe kemi identifikuar personat keqbërës, dhe ne së shpejti do të ndërrmarrim hapa konkret.

Pika 11

Informatë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Rrahman Jakupit.

Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, KKSBB-ja e ka përmashur obligimin sipas Udhëzimit Administrativ, sipas të cilët kërkohet që brenda vitit të mbahen 6 mbledhje. Në mbledhjet e mbajtura kemi pas prezent Policinë – Njësia në Shtime të cilëve unë u jamë falenderues për prezencën dhe për aktivitetet gjatë Pandemisë. Po e falënderoj edhe FSK-në për angazhimin e sajë. Gjatë takimeve të KKSBB-së, temat kanë qnë: Pandemia KOVID 19, Siguria e përgjithshme, Plani dhe raporti i punës së KKSBB-së, Trajtimi i Qenëve endacak, Vendosja e kamerave të sigurisë në Shtime etj. Jam i hapur për pyetje.

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për informatën, e cila është mjaft e shkurtër. Neve si anëtarë të Kuvendit po na intereson me ditë se cilat aktivitete janë bërë dhe vlera e tyre financiare? Po ashtu na intereson edhe aspekti i mos zbatimit të masave, për sa i përket infektimit me virusin korona, që ka ndikuar të rritet numri i të infektuarve? Këtë këshill e udhëheqë Kryetari i Komunës, mirëpo unë nuk e di a ka marrë pjesë ndonjëherë në mbledhjen e KKSBB-së?

Nënkyetari, z.Rrahman Jakupi; Dy aktivitete kryesore janë që janë mbajtur, e para e kemi aktivitetin kundër narkomanisë te Qendra Rinore, por vlerën financiare nuk e kam. Dhe aktiviteti i dytë është për zgjerimin e vendosjes së kamerave vëzhguese në Shtime. Për sa i përket zbatimit ose moszbatimit të masave personi i infektuar ka nënshkruar një pyetesorë. Të raportuara kanë qenë dy ose tri raste që kanë shkelë masat mbrojtëse si të infektuar.

znj.Arbresha Syla; Përshëndetje, unë desha të plotësoj disa të dhëna që i përkasin pandemisë Kovid19, e që lidhet me shërbimet shtëpiake që ofron QKMF-ja, kur është rritur numri i të infektuarve, nuk ka pas mundësi që të ofrohen edhe shërbimet shtëpiake. Ndërkaq dalja ka qenë për sa i përket sigurimit të terapisë. Në këtë kohë kemi mbajtur një komunikim të rregullt me Policinë për sa i përket respektimit të masave për personat e infektuar. Kështu që mund të them se puna ka shkuar mirë.

znj.Zarife Rexhaj; E përkrahu Arbreshën në diskutimin e sajë, sepse për shkak të sigurimit të terapisë kanë dalë, e që janë të nivelit terciar. Stafi i QKMF-së ka krijuar listën e personave të infektuar, dhe ka qenë e ditur se cilët persona janë të infektuar. Në përgjithësi unë personalisht jam e kënaqur me trajtimin e tyre.

z.Fehmi Hysenaj; Jo vetem dy tre persona të infektuar kanë dalë jashtë pa ndonjë arsy, por ka pas më shumë që kanë lëvizur edhe nëpër markete, e që bjen në sy se në markete nuk janë mbajtur maskat rregullisht. Kjo do të thot se dalje ka pas jo vetëm te QKMF-ja, mirëpo unë në përgjithësi mendoj se pandemija Kovid19 është menaxhuar mirë, edhe përkundër faktit se kemi numër mjaft të madh të vdekjeve.

z.Besnik Seferi; Sa i përket menaxhimit të pandemisë, mendoj se mirë është menaxhuar, mirëpo sa i përket shfrytëzimit të pauzës nga stafi i QKMF-së, unë mendoj se është dashur më mirë të planifikohet shfrytëzimi i pauzës nga stafi me qëllim që mos me leju grumbullim të njerëzve aty. Në përgjithësi për QKMF-në nuk kemi fjalë jo të mira.

znj.Arbresha Syla; QKMF-ja në Shtime nuk ka pauzë, për rastet emërgjente është e domosdoshme që stafi të jetë në dispozicion të pacientit. Pauzë janë 30 minuta para dhe pas dite.

z.Besnik Seferi; Unë thash se shërbimet janë në nivel, mirëpo unë po them se në këtë kohë pandemie, pse mos të qëndroi dikush aty, dhe kjo nuk është kritikë, por sygjerim për një rregullsi më të mirë.

zpj.Zarife Rexhaj; Sa i përket pauzës, dua të them se shfrytëzohet edhe për shkak se në atë kohë kryhet edhe dezinfektimi. Unë vetë kam punuar, dhe po e kuptoj alternativën që e dha Besniku, por arsyja përveq të tjerash është edhe dezinfektimi i hapsirave brenda QKMF-së.

Kryesuesja, zpj.Medina Brahaj; Ju falënderoj për diskutimet, dhe meqenëse për këtë pikë nuk kemi votim, po e përmbylli, duke ju falënderuar për bashkëpunimin që kemi pas gjatë vitit 2020, kërkoj që edhe në të ardhmen të kemi një bashkëpunim edhe më të mirë. Uroj që të keni shëndet dhe mbarësi në vitin e ri 2021. Të japim pozitivitet, të lëmë anash kacafytjet dhe kundërshtitë e pa arsyeshme. Ju falënderoj edhe një herë, dhe shpresoj të dalim shëndpsh e mirë nga pandemia Kovid19, e ti kthehem aktiviteteve dhe jetës së përditshme normale, urime vitin e ri 2021.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendi On-Line, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 12.²²h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj